



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:081210  
Datë: 12.06.2024  
Numri i dokumentit: 05815938

**2024:089560**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.Z. nga fsh. ...-K.Viti, me adresë në Prishtinë, rr..., numër ... lagja K., me numër personal ... e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës me dt 19.05.2022 kundër të paditurit E.A. nga fsh. Greme-K.Ferizaj, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Nezir Bytyqi nga Ferizaj, me objekt kontesti për ndarjen e pasurisë së përbashkët, pas seancës së dt. 12.06.2024, në të cilën mori pjesë paditësja dhe i autorizuari i të paditurit, me të njëjtën datë përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR** padia me shenjën 2024:089560 e paditëses L.Z. nga fsh. ...-K.Viti, kundër të paditurit E.A. nga fsh...-K.Ferizaj, me objekt kontesti për ndarjen e pasurisë së përbashkët.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes të autorizuarit të saj av. Ajvaz Islami nga Vitia, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 30.12.2015, kundër të paditurit me objekt kontesti për ndarjen e pasurisë së përbashkët.

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.863/15, të datës 16.02.2023, “I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.Z. nga fsh. ...-K.Viti dhe OBLIGOHET i padituri E.A. nga fsh. ...-K.Ferizaj që paditëses në emër të kontributit të dhënë si bashkëshorte tani ish bashkëshorte në bashkësinë jashtëmartesore me të paditurin, nga periudha 10.08.1996 deri më 13.03.2012 si amvise ka kontribuar në kryerjen e punëve shtëpiake

si: në edukimin, mbajtjen dhe përkujdesje ndaj fëmijëve, përkujdesjen ndaj burrit (ish bashkëshortit) dhe anëtarëve të tjerë të familjes, gatimi, pastrimin e shtëpisë dhe punë të tjera, ti kompensoj shumën e të hollave në vlerë prej 21.751,30€, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.”

Me Aktvendimin e Gjykatës e Apelit e Kosovës Ac.nr.1615/23, të datës 11.03.2024, “I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit E.A., nga fsh. ...-K.Ferizaj, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.863/15, të datës 16.02.2023 në pikën I dhe III të dispozitivit dhe lënda për këtë pjesë i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim. II. Pikat II dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit të lartë përmendur mbeten të pashqytuar.”

Në procedurën e rigjykimit, në seancën e dt. 12.06.2024, paditësja personalisht ka deklaruar se kam pranuar vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, e kam pranuar poashtu vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër të lëndës AC.nr.1615/2023, të dt. 11.03.2024. Është e vërtetë që av. Ajvaz Islami nga Vitia ka vdekur, të cilin e kam pasur përfaqësues të autorizuar në këtë çështje juridiko civile, avokat tjetër nuk kam angazhuar dhe as nuk e kam ndërmend të angazhojë.

Gjykata në kuptim të nenit 11, pika 1 të LPK, në seancë mori aktvendim, ku konstatohet që pala paditëse që nuk është e përfaqësuar nga avokati gjykata e udhëzon se cilat veprime procedurale mund ti kryej, sa her që konstaton se ajo nga pa dijenia , nuk i shfrytëzon të drejtat procedurale që i takojnë sipas këtij ligji. Kundër këtij aktvendimi palët nuk kishin vërejtje.

Paditësja deklaron se pas udhëzimit të gjykatës se: është e vërtetë që une jam qe për afërsisht 9 vite në procedura gjyqësore me ish bashkëshortin tim E.A. nga fsh ... Komuna Ferizaj, une kam 4 fëmijë me të njëjtin E.A.1., D.A., E.A.2. dhe O.A.. Deklarojë se me vullnet të lirë dhe të plotë pa asnjë lloj shtrengimi ose kërcënim ose lajthimi ose mashtrimi, me përgjegjësi të plotë civile, se e tërheqi padinë për ndarjen e pasurisë bashkëshortore kundër ish bashkëshortit tim të paditurit E.A. për arsye subjektive, sepse i padituri e ka gjendjen e dobët edhe po ta fitojë gjyqin kundër tij unë nuk kam se çka realizojë nga pasuria e të njëjtit. Andaj e tërheqi padinë dhe kërkojë nga gjykata të mbyllë këtë lëndë dhe të merr vendim për tërheqjen e padisë. Tjetër nuk kam asgjë çfarë të shtojë.

I autorizuari i të paditurit deklaroi se pajtohem me tërheqjen e padisë nga ana e paditëses.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Kurse gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi ashtu që secila palë i mbulon shpenzimet e veta procedurale pasi që i padituri nuk i kërkoi-specifikoi shpenzimet.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm**

**2024:089560, datë 12.06.2024**

**G j y q t a r i**

**Armend Ahmeti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.